

VENDIM
Nr. 651, datë 16.8.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E BRENDSHME, TË PASURISË SË PALUAJTSHME “SHTËPIA QENDRORE E
USHTRISË”, ME QËLLIM PAJISJEN E SUBJEKTIT PARTIA DEMOKRATIKE E
SHQIPËRISË ME NDËRTESE, PËR SELI QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 shkronja “b” e 22/1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të neneve 8 pika 3, 13 e 16 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pasurisë së paluajtshme, të konfirmuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me emërtimin “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë”, me numër rendor 32, përkatësisht sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar”.

2. Prona e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, brenda datës 20.8.2013, të përfundojnë procedurat e marrjes në dorëzim të pronës.

4. Ministri i Brendshëm të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE/
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

A				B			C			
Nr	Zona Kadast. Indeksi i hartes	Numeri Pasuris	Lloji i prones	Emertimi i prones Adresa	Siperfaqia totale prones ne M2	Nga siperfaqia totale sa nderitime ne M2	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
32				Shtepia Qendrore Ushtriise	10060 M2	1402 M2	Per trajtimin e ushtarakeve	MM Sh.Q.U Tirane	Sh.Q.U Tirane	-
				Rr.Bulevardi," Zhan D Ark "Tirane						
				Godina qendrore	1346	1346				2 kale
				Truproje	6	6				
				Berberana	50	50				
33				Shtepia e Ushtarakeve Tirane	2537 M2	1454 M2	Per trajtimin e ushtarakeve	MM Sh.Q.U Tirane	Shtepia Ushtarakeve Tirane	-
				Rr.Bulevardi," Zhan D Ark "Tirane						
				Hotel, bar,restorant	1327	1327				6 kale
				Lavanteri	127	127				
				Truall	83	-				

Ministria e Mbrojtjes

Bashkia Tirane

Fusha perdorimit te prones :
Per Mbrojtjen